

RELACION TEKNIK

Objekti: “Zgjerimi i superstradës Tiranë-Durrës (Lot 1) – Faza I”

Projekti “Zgjerim i Superstradës Tiranë – Durrës” është hartuar në vitin 2017 nga shoqëria konsulente "SPEA Engineering"

“Zgjerimi i superstradës Tiranë-Durrës(Lot 1) - Faza I (nga progresiva 0+000 ÷ 3+075), me L= 3 075 ml.

- Të dhënat gjeometrike të segmentit rrugor të projektuar.

Gjerësia e kurorës së asfaltuar	32.5 m
Korsi kalimi	3 x 3.75 m (në 2 karraxhadet),
Korsi emergjence	1 x 3 m (në 2 karraxhadet),
Bankinë e asfaltuar (krahu i majtë)	2 x 0.7 m (në 2 karraxhadet),
Bankinë (krahu i djathtë)	2 x 1.3 m (në 2 karraxhadet),
Trafikndarëse	1 x 2.6 m (në mes te 2 karraxhadeve).
Pjerrësia tërthore	2.5 %
Pjerrësia gjatësore maksimale	2.16 %
Rrezja minimale në plan	-
Rrezja minimale vertikale e muset	31 350 m
Rrezja minimale vertikale e luget	26 350 m
Shpejtësia e projektimit	140 km/orë,
Shpejtësia e lëvizjes	120 km/orë.

Punimet që do të përfshihen në (Lot1) Fazën I (nga progresiva 0+000 ÷ 3+075), me L= 3 075ml. bazuar në kapitujt e preventivit të projekt zbatimit janë si më poshtë:

Volumi 1: (Punime mbushje gjërmim, punimet e prishjes së strukturave ekzistuese dhe rialokimi i linjave ekzistuese Inxhinierike)

Nga progresiva 0+000 ÷ 3+075 do të realizohen punime gjërmimi dhe mbushje, si dhe skarifikimi i shtresave ekzistuese. Do të përfshihen punimet e prishjes së strukturave të betonit (që sot shërben si trafikndarëse). Nuk do përfshihen punimet e demontim heqje të mbikalimeve të këmbësoreve si dhe shtyllat e ndriçimit.

Volumi 2: (Shtresa rrugore)

Nga progresiva 0+000 ÷ 3+075 do të realizohen struktura të ndryshme shtresash rrugore sipas problematikave të paraqitura.

Struktura e shtresave rrugore që do të aplikohen:

- Rastit 1A dhe 1B, do të përfshihet ndërtimi i strukturës së re të shtresave rrugore (H=84cm)

Shtresë asfalt drenant me bitum të modifikuar	(4 cm),
Shtresë binderi	(5 cm),
Shtresë konglomerat bituminoz	(20 cm),
Shtresë stabilizant i trajtuar me çimento	(25 cm),
Shtresë nën-bazë	(30 cm),

- Rastit 2A, me H=54cm do të përfshihet realizimi:
Ngjeshja HMA ekzistuese dhe heqja e shtresave të tjera mbi trashësinë e kërkuar,
Ndërtimi i strukturës së shtresave të reja,
Ndërtimi i nënshtresës së granularuar poshtë që lidhet me kapacitetin mbajtës të materialeve të përdorura.

Shtresë asfalt drenant me bitum të modifikuar (4 cm),
Shtresë binderi (5 cm),
Shtresë konglomerat bituminoz (20 cm),
Shtresë Stabilizant i trajtuar me cemento (25 cm).

- Rasti 2B me H=24cm përfshin paketën e shtresave në zonën ndarëse të trafikut.

Pregatitjen e themelit me material të grimcuar,

Ndërtimin e strukturës së shtresave të reja.

Shtresë asfalti (4 cm),
Shtresë binderi (5 cm),
Shtresë bazë (15 cm).

- Rasti 3, me H=29cm do të përfshijë:

Ngjeshje të HMA ekzistuese,

Ndërtim shtresa të reja të asfaltit ,

Xhantim i asfaltit për të korrigjuar diferencat e shtresave ekzistuese.

Shtresë asfalt drenant me bitum të modifikuar (4 cm),
Shtresë binderi (5 cm),
Shtresë konglomerat bituminoz (20 cm).

Volumi 3 (Tombino dhe sistemi i drenimit)

Nga progresiva 0+000 ÷ 3+075 do të realizohen tombino rrethore, tombino katrore dhe drenimi i trupit të rrugës kryesore. Disa nga punimet që do realizohen janë:

Progresiva 2+720. - Tombino rrethore $\Phi= 800$ mm,

Sistemi i drenimit

Volumi 4 (Mbikalime dhe nënkalime këmbësore)

Nga progresiva 0+000 ÷ 3+075 propozohet të mos realizohen mbikalime këmbësore të reja, por të ruhen mbikalimet ekzistuese.(Mbikalimet e reja metalike do realizohen në një fazë të mëvonshme).

Volumi 5 (Mbikalime dhe ura)

Nga progresiva 0+000 ÷ 3+075 do të realizohet ura në progresivën 2+259 (Ura mbi Lumin e Lanës).

Volumi 8 (Perde me pilota, mure mbajtës, barriera të sigurisë dhe akustikës)

Nga progresiva 0+000 ÷ 3+075 do të realizohen:

Mure b/a (mbajtës, pritës),

Themelet me pilota të barrierave akustike nga progresiva:

0+424 ÷ 0+650,

2+400 ÷ 2+810.

Bordurë betoni në skarpatë.

Volumi 10 (Sinjalistika dhe siguria rrugore)

Nga progresiva 0+000 ÷ 3+075 do të realizohen të gjithë zërat e punimeve që kanë të bëjnë me sinjalistikën vertikale/horizontale si dhe sigurinë rrugore, ku përfshihen:

Sinjalistikë vertikale,

Sinjalistika horizontale

Vijëzim me termoplastikë me trashësi 25 cm & 15 cm,
Vijëzim me bojë bikomponente për ishujt e trafikut.
Vendosje e mbrojtësve metalike tip “Guardrail”,
Vendosje e barrierave betoni “New Jersey”,
Symace alumini çdo 25 m.